

PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS - MALL

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Blerje tuba për kanale vaditëse, Bashkia Mirditë”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Kodi sipas FPP- **44163100-1**

VLERA E FONDIT LIMIT: 3 998 680 (tremilion e nentëqind e nentëdhjetë e tete mije e gjashtëqind e tetëdhjetë) lekë pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti kontraktor Bashkia Mirditë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas shtojcës 3;*
- c. *Formulari i ofertës sipas shtojcës 1*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

- Sipas kriterëve të përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit pika 1 e kësaj shtojce (Shtojca 7).

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe Vendimit nr.2 datë 09.06.2021 “Për miratimin e dokumentave standarte të tenderit për mallra,punë,shërbime për procedurën e prokurimit “procedurë e hapur”.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Vërtetim xhiroje vjetore nga Administrata Tatimore për 3 (tre) vitet e fundit, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së parashikuar të kontratës. Kjo kerkese konsiderohet e permbushur nëqoftëse Operatorët Ekonomike arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga AK si më lart.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kriteri i pikës 2.2.1 është vendosur referuar nenit 43, pika 2/c dhe neni 55, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku është përcaktuar qartë vlera e kërkuar për xhiron minimale vjetore, dhe në pikën 3 të nenit 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 43, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe bazuar ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimet që dëshmojnë se operatori ekonomik **ka paguar detyrimet përkatëse**, për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore, në vendet ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitin 2022, sipas ligjit 9632/2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.

Pika 2.2.2 konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë në fazën e ofertimit plotësojnë Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit , sipas shtojcës 8 .

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 76, pika 2, e LPP, si dhe nenit 41, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Kriteri i pikës 2.2.3 u vendos në referencë te nenit 76, pika 2 të ligjit 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe u vlerësuan të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” dhe konkretisht në Neni 5, Rregulla të përbashkëta për taksat vendore, dhe në

KREU II, Taksat Vendore, Neni 9, Llojet e taksave vendore, të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 Për Sistemin E Taksave Vendore, (i ndryshuar).

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të ushtrorjnë aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës, me qëllim që fituesi i mundshëm të jetë në gjendje për të zbatuar në mënyrë sa më korrekte kontratën.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, që është realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet (neni 55/4/b i vkm-se 285/2021)

- a. Kjo pikë përmbushet me vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*
- b. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 40, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdosshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh

ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të zotërojë dhe të paraqesë : Çertifikatën ISO 9001:2015 ose ekuivalente, lidhur me sistemet e menaxhimit të cilësisë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit si dhe të jetë e vlefshme të akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të deklarojë që ben transportin e mallit pjese e DST-ve, me mjetet e veta sipas destinacionit dhe kërkeses se Autoritetit Kontraktor.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

Autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi për mallrat e kërkuara. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi OE duhet të paraqesë dokumentacionin për të vërtetuar lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Për vetë natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësië, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Ne respektim të nenit 36, 37 të LPP-se në të gjitha rastet kur përmendet “marke” përfshihet termi “ekuivalent”.

Sqarim per ofertuesit: Ne respektim dhe zbatim te **Ligjit nr.162/2020 date 23.12.2020 “ Per Prokurimin Publik ” neni 82 dhe VKM nr. 285, date 19.05.2021 ” Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”,neni 26 neni 39, Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoriteti kontraktor pranon si provë paraprake**, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së dhe nenit 26 te VKM nr.285, date 19.05.2021.**

Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti kontraktor detyrimisht do t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Skicimet, parametrat teknik etj:

Tub PE100

Tuba polietileni me dendësi të lartë. Tubat të kenë një koeficient sigurie minimalisht 1.2 dhe të durojnë presione te larta pune. Materjalet e përdorura për prodhimin e tubave të jene jo toksike dhe të mos ndikojnë në cilësinë e ujit (mos ti japin atij as erë as shije). Të jenë fleksibël dhe me rezistencë ndaj vibrimeve, për tu përshtatur me relievin e tokës. Të jenë rezistent ndaj rrezeve ultraviolet dhe ndaj temperaturave -25 deri në 55°C. Të kenë rezistencë të lartë ndaj gërryerjes. Pamja e jashtme: të kenë siperfaqe të lëmuar dhe pa dëmtime, të jenë ngjyrë e zezë me vija blu, prerja fundore e tubit duhet të jetë e pastër dhe në kënd të drejtë me qendrën e tubit. Produktet duhet të kenë certifikate aprovimi te leshuar nga Institucion Ndërkombëtar ose Kombetar (p.sh DVGË). Tubat HDPE duhet te vertetojne rezistencen e tyre ndaj presioneve te larta dhe deformimit mekanik ndaj forcave statike e dinamike tubat duhet te jene konform sipas standardit EN 12201 ose ekuivalent.

Tub PE 100 Pn 10 Dj-25mm

Tubat të jenë të testuar të durojnë presion minimalisht 10bar. Diametri I jashtëm 25-25.3mm, spesori 2-2.3mm.

Tub PE 100 Pn 10 Dj-63mm

Tubat të jenë të testuar të durojnë presion minimalisht 10bar. Diametri I jashtëm 63-63.5mm, spesori 3.5-4mm.

Tub PE 100 Pn 10 Dj-75mm

Tubat të jenë të testuar të durojnë presion minimalisht 10bar. Diametri I jashtëm 75-75.5mm, spesori 4.2-4.7mm.

Bashkues PE PN 10

Materiali te jete prej polipropilen me cilesi te larte te jete rezistete ndaj temperaturave nga -20 grad C deri ne 45 grad C, e faktoreve te tjere te jashtem dhe te mos jete i perbere nga substance te cilat ndikojne ne shijen dhe aromen e ujit. Koka e filetimit te jete konike per te shmangur rrjedhjet e mundshme nga diferenca e tubacioneve +5mm,-5mm. Material anti korroziv dhe perberja e materialit te jete kundra ngjitjes se algave dhe baktereve dhe te jete I pershtatshem per presione 10bar.

Saracineske me leve

Saracineska duhe te jete tipit me top dhe pajisur me leve per funksionimin e saj . Trupi I saracineskes duhet te jepe i perbere prej bronzi dhe rezistente ndaj temperaturave te jashteme nga -20°C deri ne + 45°C si edhe ndaj presioneve te larta deri ne 10 bar. Saracineskat duhet te respektojne apo te jene ne perputhje me standardin e ANSI B2.1 ose ekuivalent per sa i perket sistemit te konjeksionit apo sistemit te instalimit te tyre ne tubacione.

Permasat duhet te jene sipas preventivit.

Tub I Brinjezuar

Tub polietileni me dendësi të lartë. Të jenë ngjyrë e zezë dhe me peshe te lehte. Produkti duhet te kete rezistence te larte ndaj rrezeve UV dhe temperaturave -25 grad C deri ne + 45 grad C. Sipërfaqja e brendshme e tubit duhet te jete e lemuar qe te mundesoje rrjedhje te lirshme te ujit.

TUB I BRINJEZUAR ϕ 160

Diametri I jashtëm 160mm, Spesori në pikën e lidhjes minimalisht 2-2.5mm, Largësia e brinjëzimeve 6-7mm. Pesha 1.4-1.5kg/m. Fortesia SN8 (8 KN/m2).

TUB I BRINJEZUAR ϕ 250

Diametri I jashtëm 250mm, Spesori në pikën e lidhjes minimalisht 3.5-4mm, Largësia e brinjëzimeve 14-15mm. Pesha 2.5-3kg/m. Fortesia SN8 (8 KN/m2).

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

NJESIA E PROKURIMIT